

*Specialist në Sektorin e Projekteve, në Drejtorinë Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor*

Në zbatim të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, Ligjit nr. 72/2012 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr. 147, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor””, të ndryshuar dhe Urdhrit të Kryeministrit nr. 65 datë 19.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Autoritetit Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor”, Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor shpall konkurimin për 2 (dy) vende të lira pune në pozicionin:

➤ **Specialist në Sektorin e Projekteve, në Drejtorinë e Koordinimit dhe Projekteve, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor**

**DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË E POZICIONIT PËRMBAJNË POR NUK KUFIZOHEN NË:**

1. Ndjek projekt – planet dhe monitoron zbatimin e tyre nëpërmjet ndjekjes me rigorozet të etapave, aktiviteteve dhe kryen raportimet tek përgjegjësi i sektorit.
2. Përgatit analiza risku dhe raporte mbi realizimin e projekteve dhe produktet e përfutuara nga projektet në fushën e gjeoinformacionit;
3. Bashkëpunon me strukturat e ASIG për identifikimin e mundësive për projekte të reja.
4. Monitoron indikatorët e caktuar për monitorimin dhe realizimin e projekteve.
5. Komunikon dhe rakordon me institucionet e tjera lidhur me plotësimin e kërkesave të tyre për “produktet” e prodhuara nga informacionet gjeohapësinore.

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT**

- Të zotërojë diplomë Arsimit: Diplomë “Master profesional” në Menaxhim Biznesi/ Gjeodezi, Gjeoinformatikë/ Inxhinieri mjedisi
- Të ketë të paktën 1 (një) vit eksperiencë pune;
- Të ketë njohuri të gjëra të fushës, të teknikës së hartimit dokumenteve institucionale, aftësi për të identifikuar dhe qartësuar çështje, aftësi për të vlerësuar opsione zgjidhjesh dhe për të parashikuar pasojat nga përzgjedhja e tyre.
- Aftësi të mira komunikimi e raportimi, si dhe aftësi për të punuar ne grup.
- Aftësi për të evidentuar arritjet dhe objektivat institucionale,
- Aftësi për të dhënë mendime alternative të mbështetura në përvojën profesionale,
- Të ketë eksperiencë ne organizimin e takimeve, seminareve në sektorin që mbulon ASIG.
- Të njohë shumë mirë gjuhën angleze, dhe njohja e gjuhëve të tjera është prioritet.
- Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve bazë të kompjuterit;
- Vlerësohen certifikimet për sa më lart.

## **PAGA PËR POZICIONIN ËSHTË NË KATEGORINË (IV-a)**

### **PARAQITJA E DOKUMENTEVE:**

Kandidati duhet të dërgojë brenda datës 21.07.2023, në Autoritetin Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor në adresën: Rruga “Papa Gjon Pali II” Nd. 2, H. 3, 1010, Tiranë ose në adresën e e-mailit [info@asig.gov.al](mailto:info@asig.gov.al), këto dokumente:

- Kërkesë për aplikim
- CV
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave
- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka)
- Fotokopje të dëshmimeve të gjuhëve të huaja
- Vërtetimin e gjendjes gjyqësore
- Të paktën një letër rekomandimi
- Një numër telefoni si dhe adresën e plotë për t’u kontaktuar

Mosparaqitja e plotë dhe brenda afatit e dokumenteve sjell skualifikim të kandidatit.